



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2024:045152

Datë: 20.02.2024

Numri i dokumentit: 05345410

KPPP.nr. 2494/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Arbër Rexha, në çështjen përmbartimore të kreditorit “Coca-Cola Europacific Partners Deutschland” GmbH, me numër të biznesit HRB 173624 dhe seli në Berlin, Gjermani, përfaqësuar sipas autorizimit nga shoqëria e avokatëve RPHS Law, me seli në Prishtinë, kundër debitorit “Drini i Bardhë” Sh.P.K., me numër unik identifikues 810747876 dhe seli në Novosellë, Komuna e Pejës, të cilin e përfaqëson sipas autorizimit A.I., avokat nga Prishtina, duke vendosur sipas prapësimit të debitorit të ushtruar ndaj Urdhrit Përmbartimor P.nr. 347/22, i lejuar me datë 19.10.2022, nga Përmbartuesi Privat Kushtrim Metaj me seli në Prishtinë, jashtë seancës, me datë 20.02.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

PRANOHET si i bazuar prapësimi i debitorit “Drini i Bardhë” Sh.P.K., me numër unik identifikues 810747876 dhe seli në Novosellë, Komuna e Pejës, ndërsa Urdhri Përmbartimor P.nr. 347/22, i lejuar me datë 19.10.2022, nga Përmbartuesi Privat Kushtrim Metaj, ANULOHET.

A r s y e t i m

Përmbartuesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit “Coca-Cola Europacific Partners Deutschland” GmbH, mbi bazën Faturës nr. 102400001829, e datës 22.03.2019, si dhe Faturës nr. 102400001833, e datës 22.03.2019, ka lejuar Urdhrit Përmbartimor P.nr. 347/22, të datës 19.10.2022, me të cilin është urdhëruar debitori “Drini i Bardhë” Sh.P.K., që, brenda afatit prej 7 ditësh nga dita e pranimit të urdhrit, kreditorit t’ia paguaj shumën prej EUR 203,000.00 me kamatë prej 8% nga data e mos-përmbushjes së borxhit e deri në pagesën përfundimtare, shpenzimet e procedurës përmbartimore si dhe shpenzimet në emër të përpilimit të propozimit për përmbartim në lartësi prej EUR 325.00.

Debitori, përmes përfaqësuesit të autorizuar brenda afatit ligjor ka paraqitur prapësim me të cilin e ka kundërshtuar në tërësi si të pabazuar urdhrin përmbartimor, me arsyetim se faturat mbi bazën e së cilave është lejuar urdhri përmbartimor nuk përmbajnë afatin e përmbushjes vullnetare dhe rrjedhimisht janë në kundërshtim me nenin 29.3 të LPP-së. Ndërsa, ka shtuar se të njëjtat fatura nuk janë dorëzuar në origjinale apo kopje të vërtetuara dhe se nuk janë përkthyer në gjuhën shqipe. Me tej, ka theksuar se nuk ekziston bazë juridikisht e vlefshme që i paraprinë lëshimit dhe dorëzimit të faturave tek debitorit por se të njëjtat fatura janë paraqitur në mënyrë arbitrare, andaj kreditori nuk është i autorizuar që të kërkojë përmbushjen nga debitori, ndërsa faturat nuk kanë tipare të përmbartueshmërisë dhe nuk janë të përshtatshme për përmbartim. Në fund, ka shtuar se faturat e huaja nuk përfaqësojnë dokument të përshtatshëm për përmbartim. Për këto arsye, gjykatës i ka propozuar që prapësimin e debitorit ta aprovoj si të bazuar, ndërsa urdhri përmbartimor të anulohet.

Kreditori në përgjigje në prapësim ka theksuar se pretendimet e debitorit janë të paqëndrueshëm, ndërsa ka shtuar se urdhri është bazuar në fatura origjinale të lëshuara nga kreditori për debitorit, të cilat në kuptim të nenit 29 të LPP-së, përbëjnë dokument të besueshëm. Me tej, ka theksuar se faturat e lëshuara nga kreditori janë rrjedhojë e një kontratë për shërbime të lidhur me palëve me datë 15.09.2017, ndërsa shërbimet dhe produktet objekt të faturave janë pranuar nga ana e debitorit çka dëshmohet përmes komunikimeve elektronike, më konkretisht emalit të datës 06.12.2019. Në fund, ka theksuar se në të dy faturat në fjalë është përcaktuar edhe koha e përmbushjes, ku është theksuar se faturat duhet të paguhen menjëherë në llogarinë bankare të kreditorit. Prandaj, gjykatës i ka propozuar që prapësimin e debitorit ta refuzoj si të pabazuar, ndërsa urdhri përmbartimor të mbetet në fuqi.

Gjykata, pas shqyrtimit të pretendimeve të palëve, si dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbartimore, (në tekstin e mëtejshëm: “LPP”) gjykata gjen se prapësimi i debitorit është i bazuar dhe se urdhri përmbartimor duhet të anulohet, për shkaqet si në vijim:

Sipas nenit 29, paragrafi 1 i LPP-së: “Përmbartimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm”, ndërsa, pika 1.3 e njëjtit nen ka përcaktuar faturën si dokument i besueshëm sipas të cilit mund të caktohet përmbartimi për realizimin e kërkesës në të holla. Tutje, në paragrafin 3 të këtij neni është përcaktuar se: “Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbartim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar”. Në anën

tjetër, me nenin 37 të LPP-së parashihet se: *“Kur propozimi për përmbaerim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t’i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit.*

Gjykata, duke u bazuar në të lartcekurat gjeti se Fatura nr. 102400001829 e datës 22.03.2019, si dhe Fatura nr. 102400001833, e datës 22.03.2019, mbi bazën e së cilave është paraqitur propozimi për përmbaerim dhe është lejuar urdhri përmbaerimor, nuk i plotësojnë kushtet për të qenë dokumente të besueshme, ngase nuk mund të vërtetohet që të njëjtat fatura janë dorëzuar në mënyrë të rregullt nga ana e kreditorit dhe se janë pranuar nga debitori, për arsye se të njëjtave iu mungon nënshkrimi apo vula e pranimi të debitorit. Në anën tjetër, kreditori nuk ka arritur të dëshmoj se në ndonjë mënyrë tjetër të përshtatshme ia ka dorëzuar debitorit faturat objekt përmbaerimi. Andaj, si të tilla faturat mbi të cilat është lejuar urdhri përmbaerimor nuk janë të përshtatshme për t’iu nënshtruar përmbaerimit.

Gjykata ka vlerësuar pretendimet e kreditorit se nga komunikimet elektronike të bashkangjitura në propozim për përmbaerim vërtetohet se debitori ka pranuar shërbimet dhe produktet të cilat evidentohen në fatura, mirëpo gjeti se të njëjtat pretendime nuk mund të janë objekt trajtimi në procedurë përmbaerimore, ngase kjo procedurë i nënshtrohet parimit të rigorozitetit formal në bazë të cilit nuk lejohet vlerësimi i rrethanave tjera, përjashtimisht vlerësimi të elementeve formale të dokumentit në bazë të cilit është lejuar përmbaerimi, si dhe përshtatshmërisë së dokumentit objekt përmbaerimi, ashtu siç kërkohet me dispozitat e neneve 21 dhe 29 të LPP-së. Andaj, meqenëse në rastin konkret kreditori nuk ka bashkangjitur ndonjë provë me të cilën do të vërtetohet se faturat i janë dorëzuar debitorit dhe se të njëjtat debitori i ka pranuar duke u pajtuar me përmbajtjen dhe lartësinë e tyre, gjykata vlerëson të njëjtat fatura, si të tilla, përbëjnë dokumente të njëanshme dhe rrjedhimisht nuk janë të përshtatshme për përmbaerim.

Për më tepër, gjykata gjen se zbatimi i dokumentit të besueshëm të lëshuar nga një subjekt i vendit të huaj sikurse në rastin konkret, duhet t’i nënshtrohet zbatimit të dispozitave të nenit 11 të LPP-së, sipas të cilit *“Përmbaerimi i dokumentit të huaj përmbaerimor do të caktohet dhe zbatohet sipas këtij ligji, nëse dokumenti përmbaerimor i huaj i plotëson kushtet e parapara me ligj apo marrëveshje ndërkombëtare për pranim dhe përmbaerim.”*

Gjithsesi, gjykata rikujton se vendosja në këtë çështje përmbaerimore nuk e paragjykon të drejtën e palës kreditore që, lidhur me pretendimet për borxhin sipas faturave, të inicioj proces të rregullt kontestimor pranë gjykatës kompetente.

Duke u bazuar në të lartcekurat, gjykata vlerëson se në rastin konkret dokumentet, mbi të cilat mbështetet propozimi për përmbarim, e mbi bazën e të cilit përmbaruesi privat ka lejuar përmbarimin, nuk kanë tipare të përmbarueshmërisë dhe si rrjedhojë edhe urdhri i lejuar nga ana e përmbaruesit duhet të anulohet.

Nga sa më sipër, gjykata në kuptim të nenit 71, paragrafi 1.1 dhe 73 të LPP-së, si dhe nenit 13, paragrafi 1, pika 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr. 2494/22, datë 20.02.2024

Gjyqtari
Arbër Rexha

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimt të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së Parë të kësaj Gjykate.